



KOMUNA LEKBIBAJ
PARKU NATYROR RAJONAL "NIKAJ-MERTUR"

RREGULLORE

(Nr _____ date _____ 2014)

PËR
RUAJTJEN, ADMINISTRIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E PARKUT NATYROR RAJONAL "Nikaj-Mërtur"

Në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 8906, datë 06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura", i ndryshuar, dhe pikës 5/d të VKM nr. 519, datë 30.06.2010 "Për procedurat e propozimit e të miratimit dhe rregullat e administrimit të parqeve natyrore rajonale" miratohet kjo rregullore:

KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kesaj rregullorje eshte administrimi dhe menaxhimi i Parkut Natyror Rajonal "Nikaj-Mërtur", nën administrimin të Komunës Lekbibaj.

Neni 2
Qëllimi

Dispozitat e kësaj rregulloreje kanë për qëllim:

- a. të sigurojnë ruajtje e përdorim të qëndrueshëm të Parkut Natyror Rajonal "Nikaj-Mërtur";
- b. të sigurojnë administrim dhe menaxhimin bashkëkohor të tij;
- c. të garantojnë që aktivitetet e lejuara brenda dhe në afersi të parkut, të cilat organizohen dhe funksionojnë duke respektuar normat, standartet dhe kërkesat ligjore dhe parimin e zhvillimit të qëndrueshëm;
- d. të nxisin bashkëpunimin midis administratës së parku rajonal dhe aktorëve të interesuar, ne nivel lokal, kombetar dhe nderkombetar;
- e. të promovojë vlerat natyrore e turistike të zonës në kuadër të zonës së mbrojtur.
- f. Te rrisë ndergjegjesimin dhe informimin e publikut ne drejtim te mbrojtjes se natyres
- g. Evidentimin dhe adresimin e problemeve te barazise gjinore ne zone.
- h. Zhvillimin e bazuar ne traditat e zones
- i. Funksionimin e nje programi kerkimi dhe monitorimi ne park
- j. Zbatimin e programit financiar, ne kuader te planit te menaxhimit

Neni 3
Fusha e zbatimit



Dispozitat e kësaj rregullorejeje zbatohen në gjithë sipërfaqen e Parkut Natyror Rajonal dhe rregullojnë ruajtjen, menaxhimin e territorit dhe të burimeve natyrore e biologjike të tij; zhvillimin tradicional, të turizmit dhe promovimin e vlerave, nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe për përfitime ekonomike e sociale nga popullsia vendore, nga sektori publik dhe privat.

KREU II ADMINISTRIMI I PARKUT NATYROR RAJONAL

Neni 4

Plani i menaxhimit

1. Parku Rajonal ruhet dhe administrohet duke zbatuar kërkesat e planit të menaxhimit.
2. Plani i menaxhimit është dokument pune, që përfshin masa të gjithanshme për mire-administrimin dhe udhëzimet praktike për ruajtjen e tij. Hartimi dhe zbatimi i tij garanton mbrojtjen e parkut rajonal dhe ndihmon në kualifikimin e administratës dhe të personelit përgjegjës.
3. Në planin e menaxhimit, për çdo nënzonë administrimi, jepet një përshkrim i synimeve, qëllimi i menaxhimit, i ruajtjes dhe veprimtarite ekonomike, sociale, argëtuese-sportive, etj, ku cilësohen:
 - veprimtaritë e papajtueshme (të cilat konsiderohen qartësisht të papajtueshme me qëllimet e zonës dhe që përgjithësisht nuk lejohen të kryhen në atë zonë me përjashtim të rrethanave të veçanta, të përcaktuara me dispozita ligjore të tjera);
 - veprimtarite e lejuara (të cilat nuk kërkojnë miratim menaxhimi individual sa herë që ato ndërmerren dhe studime për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe leje mjedisore);
 - veprimtarite që kërkojnë miratim për menaxhimin e tyre (te cilat nuk janë qartësisht të papajtueshme me qëllimet e zonës, por që mund të kenë impakte negative dhe për këtë arsye kërkojnë miratim rast pas rasti, të shoqëruar edhe me vlerësimin e ndikimit në mjedis).

Neni 5

Administrimi i Parkut Natyror Rajonal

1. Veprimtaritë administruese të parkut rajonal përfshijnë:
 - a. mbrojtjen dhe konservimin në vijimesi të gjendjes natyrore, të biodiversitetit, të vlerave lokal, përfaqësuese dhe të karakteristikave të veçanta të tij;
 - b. monitorimin dhe kontrollet e vijueshme që evidentojnë gjendjen reale të parkut rajonal;
 - c. lehtësimin e kushteve dhe mbështetjen për zhvillimin e studimeve, kërkimeve shkencore e të monitorimit në nivel lokal;
 - d. përdorimin e qëndrueshëm të burimeve bio-natyrore, të pyjeve, kullotave, ujerave, peshkimit, gjuetia, dhe territorit për qëllime ekoturistike, etj;
 - e. veprimtarite promovuese, popullarizuese e propaganduese të vlerave të tij.
 - f. Promovimin e vlerave të parkut (natyrore, historike, kulturore, tradicionale)
2. Ruajtja dhe administrimi i parkut rajonal përfshin detyrimisht edhe mirembajtjen e mjediseve rreth tokave bujqësore, pyjet, ujerat, etj., si pjesë e domosdoshme e tij.



Neni 6 Sipërfaqja dhe Kufijtë e Parkut Natyror Rajonal

1. Sipërfaqja e Parkut Natyror Rajonal është **17,505** ha dhe përbëhet nga:

Nr.	Përdorimi i territorit	Sipërfaqja (ha)
1.	Sipërfaqe e çveshur dhe shkembore	3,863.5
2.	Qendra te banuara, toke bujqesore etj	1,013.4
3.	Siperfaqe me kullota, livadhe etj	949.4
4.	Siperfaqe me Rrobull (Pinus heldreichii)	461.2
5.	Siperfaqe me pshte te zeze (Pinus nigra)	99.0
6.	Siperfaqe me dushqe, geshtenje, lajthi etj	3,965.6
7.	Pyje me ah etj.	7,152.9
SIPERFAQE E PERGJITHSHME		17,505

2. Kufijtë e Parkut Natyror Rajonal janë, si më poshtë vijon:

- Kufiri verior:** Kufizohet me Parkun e Alpeve Shqiptare dhe fillon ne; Majen e Boshit, maja Suka e Zhapores, Maja e Zhapores, Maja e Brijasit, Maja e Gavnit, Qafa e Drockes, Maja e Alshines.
- Kufiri lindor:** Maja e Dhive, Maja e Shtylles, Maja e Mekines, Qafa e Kolcit, Maja e Merturit, dhe zbret per kurrizit të malit ne drejtim te Liqenit te Komanit.
- Kufiri jugor:** Si kufi natyral eshte liqeni i Komanit.
- Kufiri perëndimor:** Nis me kufizimin me komunen e Shales (Malesi e Madhe) dhe fillon ne; liqenin e Komanit, ngjitet per kurrizi ne kuoten 1180 m ne perendim te fshatit Brisë, vazhdon drejt kuotes 1424 m, qafa e Agrit, maja e Agrit (1607 m), Maja e Ershelit, Maja e Shtrezes, Maja e Brodes, Maja e Kakise, qafa e Kakise, Maja e Boshit.

Neni 7 Zonimi i sipërfaqes së Parkut Natyror Rajonal

1. Zonimi është zakonisht rruga më e mirë për të siguruar mbrojtjen e rreptë të një nënzona kryesore dhe të nënzona të tjera për një përdorim shumëdisiplinor në përputhje me objektivat e zgjedhur, duke lejuar aktivitete të ndryshme në pjesë të caktuara të parkut rajonal.



2. Plani i zonimit është mjet me të cilin planifikuesit dhe menaxheret përcaktojnë qëllimet për çdo pjesë të nënzonave që mund të përdoren, sipas kesaj metodollogjie:

2.1. Zona Qendrore

Zona qendrore, me sipërfaqe **1105.6** ha, e shënuar në hartë me ngjyrë të gjelbër. Përcaktohet si zonë me vlera të larta për trashëgiminë natyrore e biodiversitetin lokal, siguron një territor të pa-shqetësuar dhe zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes.

2.2. Zona e Perdorimit Tradicional

Zona e përdorimit tradicional, me sipërfaqe **11,720.8** ha, e shënuar në hartë me ngjyrë kafe në të verdhë. Përfshin tërësisht pjesë dushkajave dhe liqenit: ku mundësohet vazhdimi i veprimtarive tradicionale si bujqësi, peshkim, pyje, grumbullimi i bimëve mjekësore dhe i prodhimeve të dyta pyjore, me përdorim të balancuar të tyre, pasi të pajisen me leje përkatëse dhe zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes.

2.3. Zona e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Zona e zhvillimit të qëndrueshëm, me sipërfaqe **4,678.6** ha, e shënuar në hartë me ngjyrë gri. Në këtë zone lejohen veprimtari të cilat nuk cenojnë integritetin ekologjik të ekosistemit natyror dhe ushtrohen vetëm me leje që nuk bien ndesh me planin e menaxhimit dhe zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes.

2.4. Sipërfaqja e zonave përbërëse të Parkut Natyror Rajonal "Nikaj-Mertur";

Nr	Emertimi i zones	Sipërfaqja në ha
1	Zona qendrore	1105.6
2	Zona e përdorimit tradicional	11,720.8
3	Zona e zhvillimit të qëndrueshëm	4,678.6
	Totali	17,505

KREU III MBROJTJA E PARKUT NATYROR RAJONAL

Neni 8 Qëllimet e mbrojtjes

1. Mbrojtja synon konservimin dhe ruajtjen e veçorive natyrore e biologjike, gjeologjike, gjeomorfologjike dhe hidrologjike kunder ngacmimit, demtimit apo shkaterrimit, duke përfshirë zbatimin e teknikave menaxhuese që janë miqësore me mjedisin, që menjanojnë ndikimet e dukurive natyrore, si dhe veprimet e dëmshme të njeriut mbi pamjen dhe vlerat e Parkut Natyror Rajonal.
2. Mbrojtja përfshin masat e dëmtimeve nga zjarri, insektet e sëmundjet, ndotja e mjedisit, helmet, erozioni, pyjet, peshkimin, gjuetinë, kullotjen, etj si dhe përdorimin e kontrolluar të mjeteve.
3. Mbrojtja është e lidhur me rehabilitimin dhe përmirësimin e gjëndjes së territorit në pergjithësi, përmes hartimit dhe zbatimit të projekteve që sigurojnë një administrim të qëndrueshëm të tyre si dhe shtim e gjenerim të sigurtë të burimeve natyrore.



4. Çdo përdorim i territorit të Parkut Natyror Rajonal dhe i burimeve natyrore, lejohet vetëm kur siguron mbrojtjen dhe pastertinë e tij, ruajtjen e mikroklimës, të regjimit ujor, ekosistemeve, tipareve gjeologjike dhe gjeomorfologjike, të gjetjeve arkeologjike dhe të gjallesave që jetojnë në të, ruajtjen e arkitektures tradicionale, zakoneve dhe traditave.
5. Mbrojtjen dhe përdorimin e vlerave kulturore, historike, arkitektonike, objekte arkeologjike dhe të peizazhit.

Neni 9

Mbikqyrja dhe kontrolli i Parkut Natyror Rajonal

1. Mbikqyrja dhe kontrolli i parkut rajonal janë veprimtari të përhershme dhe të programuara që synojnë evidentimin e gjëndjes natyrore e fizike të parkut rajonal dhe të mjedisit rreth tij, rreziqet që u kanosen, dëmtimet që mund të kenë pësuar, ndërhyrjet e shërbimet e veçanta që garantojnë jetëgjatësinë e tij.
2. Mbikqyrja dhe kontrolli i Parkut Natyror Rajonal kryhet nga strukturat përkatëse të Komunës, ndryshe Administratat e Parkut Rajonal, personeli i shërbimit pyjor, inspektoriati i mjedisit, inspektoriati i peshkimit dhe policia pyjore, nga strukturat e ngarkuara shtetërore e vendore si dhe individë.
3. Rezultatet e mbikqyrjes e të kontrollit pasqyrohen në dokumenta operative dhe shërbejnë për hartimin e programeve dhe të masave për përmirësimin e gjëndjes.
4. Ruajtja e Parkut Natyror Rajonal kryhet duke patur parasysh dispozitat e ligjore dhe aktet nenligjore në zbatim të ligjit "Për zonat e mbrojtura" dhe të dispozitave të tjera në fuqi që lidhen me përdorimin e territorit dhe të burimeve natyrore.
5. Administrata e Parkut Rajonal mbikqyr e ruan edhe objektet kulturore, historike, arkitektonike dhe arkeologjike në zonen e Parkut Natyror Rajonal.

Neni 10

Veprimtari të ndaluara

1. Në territorin e Parkut Natyror Rajonal përjashtohet çdo veprimtari shfrytëzimi dhe në të ndalohen veprimtaritë, sipas përcaktimit të bërë në dispozitat e ligjit nr. 8096, datë 06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar, ato të përcaktuara në planin e menaxhimit dhe ato që nuk janë të miratuara në studimet urbanistike.
2. Në territorin e Parkut Natyror Rajonal, në lidhje me menaxhimin dhe përdorimin e burimeve ujore, zbatohen detyrimet që dalin nga legjislacioni përkatës "Për rezervat ujore" dhe vendimet e marra nga autoritetet administruese dhe menaxhuese të bazeneve.
3. Për aktivitetin e peshkimit e të akuakultures zbatohen detyrimet që dalin nga legjislacioni përkatës dhe rregullorja/et e peshkimit e miratuar nga Ministri i Mjedisit.
4. Për aktivitetin e pyjeve, kullotjes, gjuetisë, prodhimeve të dyta zbatohen detyrimet që dalin nga legjislacioni përkatës, aktet nenligjore edhe rregulloret e miratuar nga Këshilli i Qarkut dhe Ministria e Mjedisit si dhe në kuadër të udhëzimeve të planeve të menaxhimit



te pyjeve komunale, duke koordinuar nderhyrjet e mirëmbajtjes, të përmirësimit të struktures dhe të përbërjes.

5. Nuk lejohet; përdorimi i preparateve kimike, ndotesit, mostrajtimi i ujerave të zeza, mbetjet urbane e industriale etj, brenda dhe rreth territorit të parkut rajonal, kur ata sjellin efekte negative, kur demtojnë tokën, ajrin dhe ujin, si dhe kur tejkalojne normat e lejuara me ligje a akte te tjera nën-ligjore.

Neni 11

Rehabilitimi i mjedisve dhe objekteve të Parkut Natyror Rajonal

Ndërhyrjet në zonën e Parkut kryhen kur ndodh:

1. Rehabilitimi i mjedisit, brenda dhe rreth Parkut Natyror Rajonal dhe rritja e integritetit ekologjik të tij, kryhen nepërmjet veprimtarive mbrojtëse e konservuese, për të rivendosur kushtet ekologjike, natyrore të nevojshme.
2. Rehabilitimi i burimeve bionatyrore dhe marrja e masave parandaluese kryhet duke zbatuar praktikant tradicionale bujqesore e silvikulturore si dhe projektet bashkekohore të rimëkëmbjes.
3. Rikthimi në gjendje normale i burimeve natyrore të paripërteritshme të dëmtuar, bëhet nëpërmjet zbatimit te planeve dhe projekteve të veçantë të rimëkëmbjes, pasi janë percaktuar me pare ne planin perkates te menaxhimit te parkut dhe per te cilat hartohen projektet perkatese te zbatimit te aprovuara nga autoritetet menaxhuese te parkut.
4. Mbrojtja e tokës, ndalimi i degradimit dhe i erozionit te saj në mjediset e kercenuar e të dëmtuar, realizohet sipas projekteve te miratuar nga autoritetet menaxhuese te parkut.
5. Mbështetja e bujqësisë përmes programeve, stimujve, projekteve që inkurajonë zhvillimin dhe promovimin e produkteve tradicionale lokale, gjithëpërfshirjen e fermerëve në menaxhimin e tokës, të bujqësisë organike e agro-silvikulturore, të cilesisë së shërbimeve të strukturave tradicionale si dhe të gjitha mundësitë e tjera që kombinojnë mbrojtjen e mjedisit natyror e peizazhit te Parkut Natyror Rajonal me nevojat ekonomike të banoreve dhe biznesit.
6. Ripërteritja apo ripyllezimi, në rastet e demtimeve të rënda, bëhet duke përdorur të njëjtin lloj drurësh dhe bimësi autoktone.
7. Rehabilitimi i zonave me bime mjekësore, eterovajore e tanifere bëhet në rrugë natyrore.
8. Rehabilitimi i burimeve ujore bëhet pas studimeve të kryera nga specialiste të fushës dhe në bazë të legjislacionit në fuqi për këtë problem, dhe pasi të jetë marrë me pare aprovimi i autoriteteve perkatese.
9. Të gjithë kërkesat për rehabilitimin e llojeve dhe të habitateve të zonës së mbrojtur do të kryhen sipas legjislacionit në fuqi me aprovimin e autoriteteve te parkut, do të monitorohen nga komuna, shërbimi pyjor dhe ministria e mjedisit.
10. Ndërtimi i infrastruktures së nevojshme dhe përdorimin e tyre, për qëllime të ekoturizmit, bëhen në përputhje me projektet e miratuar nga organet përgjegjëse.



11. Rehabilitimi i ndërtimeve dhe objekteve historike, arkitektonike, dhe arkeologjike, behet sipas projekteve të miratuara nga organet kompetente dhe autriteti menaxhues i parkut.

KREU IV PROMOVIMI DHE PËRDORIMI I VLERAVE TË PARKUT RAJONAL

Neni 12

Promovimi i vlerave natyrore e turistike te parkut rajonal

1. Mbështeten të gjitha projekte dhe aktivitetet në zbatim të programeve për promovimin e vlerave natyrore, të biodiversitetit, peizazhit, historike, kulturore, arkeologjike, fetare, didaktike dhe turistike te Parkut Natyror Rajonal.
2. Promovohen dhe zbatohen programet e studimit dhe edukimit per natyrën, florën e faunën, historine, kulturën, të strukturave tradicionale dhe karakteristike për vizitorët dhe në veçanti për shkollat përreth Parkut Natyror Rajonal.
3. Promovohen dhe zbatohen programet e përdorimit tradicional të tokës, bujqësisë, pyjeve, kullotave, ujerave, peshkimit, gjuetinë, prodhimet e dyta e bimët mjekësore, prodhimet artizanale etj, që mund të përbëjnë si shembuj tipike për vlerat dhe aktivitete e Parkut Natyror Rajonal.
4. Promovimin dhe organizimin e aktiviteteve brenda Parkut Natyror Rajonal, duke përfshire nxitje për zhvillimin e panairove me produkte tradicionale karakteristike të zonës apo rajonit, si dhe percaktimin dhe festimin e festave të ndryshme fetare e historike.
5. Përcaktimi dhe ngritja e infrastruktures së pritjes së vizitorëve, të parkimeve, të zonave ku lejohen veprimtarite argëtuese, sportive tokësore e ujore, shlodhëse, kampingjeve, shtigjeve, kullave të vrojtimit, tabelave sinjalizuese dhe informuese, brenda dhe në afërsi të Parkut Natyror Rajonal.
6. Përgatitjen dhe shpërndarjen e udhërrëfyesve, broshurave e albumeve, hartave, flet-palosjeve, guidave e materialeve të tjera informuese, të cilet jane të domosdoshme për orjentimin e vizitoreve e të turistëve, që duan të frekuentojnë Parkun Natyror Rajonal;
7. Sensibilizimi i komunitetit vendas për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të trashëgimisë natyrore, peizazhore, estetike, kulturore, historike, arkeologjike dhe të larmisë biologjike e gjeomorfologjike të Parkut Natyror Rajonal.
8. Promovohen e gjithë arkitektura tradicionale ne zone (kullat e banimit, kulla e ngujimit, ndërtesa historike etj.) si nje menyre per te ruajtur pejzazhin tradicional, per te terhequr vizitorët dhe per te ofruar mundesine e vizitave ne keto ndertime.
9. Promovohen festat lokale (duke hartuar, publikuar e ftuar) si nje menyre e mire per te treguar vlerat e Parkut Natyror Rajonal dhe vecanerisht te banoreve te tije.



10. Promovohen traditat e zones (mikpritja, bujaria, zakone e tradita), duke bere qe banoret e Parkut Natyror Rajonal te ndihen krenarë dhe pjese e rendesihme e tij.

KREU V

ORGANI PËRGJEGJËS DHE STRUKTURA ADMINISTRUESE

Neni 13

Organi pergjegjes

1. Organi kryesor përgjegjës për ruajtjen dhe administrimin e Parkut Rajonal, janë strukturat ligjore të Komunës Lekbibaj.
2. Këshilli i Komunës, për administrimin dhe menaxhimin e parkut rajonal, ka detyrë:
 - a) pranimin e projekt-idesë për krijimin e Parkut Natyror Rajonal;
 - b) shqyrtimin e studimit dhe propozimin për shpalljen e Parkut Natyror Rajonal, të cilin ia dërgon Këshillit të Qarkut për miratim;
 - c) pranimin e rregullores së ruajtjes, administrimit dhe funksionimit të parkut rajonal dhe e dërgon atë për miratim në Këshillin e Qarkut bashkë me kërkesën e vendimit;
 - d) Miraton strukturën për krijimin e administratës për ruajtjen dhe menaxhimin e Parkut Natyror Rajonal, pas miratimit të propozimit nga Këshilli i Qarkut;
 - e) mbikqyrjen e zbatimit e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen e natyrës dhe të biodiversitetit për parkun rajonal;
 - f) zbatimin e gjithanshem të kërkesave të Parimit të Zhvillimit të Qëndrueshëm;
 - g) respektimin e detyrimeve të dala nga aprovimi i Planit të Menaxhimit;
 - h) zbatimin e rregullave të caktuara për zhvillimin e veprimtarive ekonomike, sociale, turistike, argëtuese e sportive dhe të biznesit në nivel lokal në përputhje me planin e menaxhimit dhe objektivat e tij;
 - i) kontrollon kryerjen e çfarëdolloj ndërtime apo infrastrukture brënda territorit të Parkut Natyror Rajonal, të mbështetura në studimet urbanistike dhe sipas dispozitave të ligjit "Për planifikimin e territorit" dhe të ligjit "Për zonat e mbrojtura".
 - j) mbikqyrjen e administrimit dhe të efektivitetit të fondeve financiare dhe të investimeve të planifikuara për ruajtjen, zhvillimin dhe promovimin e vlerave të Parkut Natyror Rajonal;
3. Kryetari i Komunës për administrimin dhe menaxhimin e parkut rajonal, ka këto detyra kryesore:
 - a) Në bashkëpunim me specialistet e fushës harton dhe shpall projekt-propozimin për shpalljen e Parkut Natyror Rajonal, ku përcaktohen sipërfaqja që synohet të shpallet park, kufijte dhe shkalla e ruajtjes së tij;
 - b) propozimi për shpalljen e Parkut Natyror Rajonal duhet të jetë në përputhje me strategjitë sektoriale të veprimtarive që parashikohet të zhvillohen, planet e veprimit e programet e zhillimit të Qarkut dhe kërkesat e Strategjisë e të Planit të Veprimit për Biodiversitetin;
 - c) Mbeshtet studimin për identifikimin e vlerave të zonës, hartimin e kufijve dhe krijimin e parkut rajonal dhe e dërgon për miratim në Këshillin e Komunës;



- d) mbështet hartimin e rregullores së ruajtjes, administrimit dhe funksionimit të parkut rajonal dhe e përcjell për shqyrtim në Këshillin e komunës;
- e) mbështet hartimin e planit të menaxhimit për Parkut Natyror Rajonal dhe e përcjell për shqyrtim në Këshillin e Komunës, Qarkut dhe Ministrinë e Mjedisit;
- f) planifikon fondet financiare për mbështetjen e programeve të ruajtjes, rehabilitimit dhe për infrastrukturën e pritjes së vizitorëve, të zhvillimit të turizmit dhe promovimit të Parkut Natyror Rajonal dhe menaxhimit të tij;
- g) studion dhe paraqet strukturën dhe numrin e punonjësve të administratës së Parkut Natyror Rajonal dhe e përcjell ato për miratim në Këshillin e Komunës; gjithashtu propozon kriteret e pranimit, emërimit dhe lirimet nga detyra dhe për secilin punonjës bëhet përkrahimi i vendit të punës, i detyrave, përgjegjësisë dhe i të drejtave të tyre;
- h) kryen emërimet dhe lirimet nga detyra të personelit të administratës së Parkut Natyror Rajonal dhe vlerësimin e efektivitetit të punës së punonjësve të parkut;
- i) kontrollon veprimtaria e administratës në përputhje me dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi dhe mbështet zbatimin e politikave mbrojtëse e menaxhuese, brenda kuadrit të ruajtjes së natyrës dhe të biodiversitetit të vendit;
- j) analizon dhe propozon masa për ruajtjen dhe mirëadministrimin e Parkut;
- k) publikon çdo vit të dhënat për gjëndjen e Parkut Natyror Rajonal dhe ia përcjell Këshillit të Qarkut dhe Ministrisë së Mjedisit.
- l) drejton dhe organizon, në bashkëpunim me institucionet kërkimore-shkëncore, me institucionet arsimore e kulturore, me OJF-te mjedisore, me komunitetin, etj, veprimtari ndërgjegjësuëse për të bërë të njohura vlerat e parkut.
- m) Lobon pranë organizatave e donatoreve të ndryshëm, autoriteteve shtetërore etj. si dhe lidh kontratat përkatëse me to, për fonde të ndryshme me qëllim menaxhimit sa më efektiv të Parkut Natyror Rajonal.

4. Për Parkut Natyror Rajonal, struktura përgjegjëse e komunes krijon dosjen individuale në të cilën sistemohet dokumentacioni dhe duhet të pasqyrohet:

- a. identifikimin e Parkut Natyror Rajonal me harta dixhitale, skica, planimetri, fotografi, vendosjen e shenjave të ndryshme dalluese për kufijt natyror të tij, etj;
- b. veprimtaritë e kryera për ruajtjen e gjëndjes së tij natyrore;
- c. projekte e nisma për përmirësimin e situatës së Parkut Natyror Rajonal;
- d. veprimtaritë promovuese.

5. Dokumentacioni i sistemuar për Parkun Natyror Rajonal mbahet në komunë, nga administrata e tij dhe një kopje nga strukturat përgjegjëse të Këshillit të Qarkut.

6. Dokumentacioni i Parkut Natyror Rajonal administrohet sipas rregullave të njohura të administrimit të dokumentacionit zyrtar dhe bën pjesë në fondin e dokumentave mjedisore që ruhen përgjithmonë.

7. Dokumentacioni i Parkut Natyror Rajonal është i hapur dhe i shfrytëzueshem për studiuesit, për të interesuarit dhe për publikun, duke zbatuar rregullat e kërkesat ligjore që përdoren për shfrytëzimin e arkivave.

Neni 14

Administra e Parkut Natyror Rajonal

1. Administrata është struktura teknike përgjegjëse në terren për zbatimin e planit të menaxhimit dhe të programeve të ruajtjes së natyrës, biodiversitetit, si dhe të aktiviteteve ekonomike, sociale dhe ekoturistike brenda Parkut Natyror Rajonal.



2. Administrata e parkut rajonal është strukture në varësi të komunës dhe trajtimi financiar i punonjësve të saj është i njëjtë me atë të punonjësve të tjerë.
3. Për kryerjen e detyrave të saj administrata bashkëpunon me personelin e shërbimit pyjor, inspektoriatin e mjedisit, të peshkimit dhe policinë pyjore; me këshillat e baseneve ujëmbledhës, me organet shtetërore lokale, institucionet kërkimore-shkencore, organizatat lokale të peshkimit, të biznesit, të agjensive turistike, OJF-t dhe të përdoruesit privat, etj, për ruajtjen, menaxhimin dhe promovimin e Parkut Natyror Rajonal.
4. Administratën bën mbikqyrjen dhe ruajtjen e gjendjes natyrore të parkut, të vlerave mjedisore, të natyrës e të peizazhit si dhe të veçorive të trashëgimise kulturore, historike, arkeologjike, gjeologjike e shpirtërore;

Neni 15

Funksionet e administratës

1. Administrata kryen funksione administruese dhe menaxhuese, duke menaxhuar Parkun Natyror Rajonal në të gjithë treguesit që sigurojnë ruajtjen e gjendjes së tij natyrore dhe përdorimin e qëndrueshem të vlerave që ai ofron.
2. Administrata kryen funksione kontrolluese dhe ruan Parkut Natyror Rajonal dhe përbërësit e vlerat e tij nga dëmtimet, ndotjet e keqpërdorimet, duke ndëshkuar, sipas ligjit, shkeljet e konstatuara.
3. Veprimtaria e administratës është në përputhje me dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi dhe siguron zbatimin e politikave mbrojtëse e menaxhuese të hartuara nga organet lokale dhe integrimin e tyre, brenda kuadrit të ruajtjes së natyrës dhe të biodiversitetit të vëndit.

Neni 16

Detyra të përgjithshme të administratës

1. Administrata kryen këto detyra dhe shërbime:
 - a) Përgjigjet për ruajtjen dhe administrimin e Parkut Natyror Rajonal dhe për monumentet e natyrës që gjenden brenda sipërfaqes nën juridiksion të komunës;
 - b) ndjek zbatimin e planit të menaxhimit të Parkut Natyror Rajonal;
 - c) propozon dhe zbaton masat dhe programet për ripërtëritjen e mjediseve të dëmtuara, të shkatëruara apo të degraduara të parkut rajonal;
 - d) parandalon përdorimin e mjeteve apo metodave që çojnë në degradimin e natyrës dhe të biodiversitetit;
 - e) përcakton vendet e vendosjes së tabelave dhe shenjave treguese dhe të shtigjeve të kalimit për vizitorët;
 - f) ndëshkon në raste kundërvajtjesh sipas legjislacionit në fuqi;
 - g) kontrollon dhe këshillon përdoruesit e tokës, pyjeve, ujerave, peshkimit, kullotjes, gjuetisë, dhe vizitorët;
 - h) mban dhe plotëson skedarin e Parkut Natyror Rajonal;
 - i) ndjek përdorimin dhe frytshmërinë e fondeve për mirëmbajtjen e parkut;
 - j) dokumenton veprimtaritë, investimet, kërkimet shkencore të kryera në territorin e



Parkut Natyror Rajonal;

k) organizon, në bashkëpunim me strukturat e tjera të komunës, me institucionet kërkimore-shkencore, me institucionet arsimore e kulturore, me OJF-te mjedisore, me komunitetin, etj, veprimtari ndërgjegjësuese për të bërë të njohura vlerat e zonës;

l) përgjigjet dhe miremban infrastrukturën e informimit e pritjes së vizitoreve dhe organizon veprimtaritë informuese, edukuese dhe vizitat ekoturistike;

m) bashkërendon festimin e ditëve dhe aktiviteteve mjedisore që lidhen me Parkun Natyror Rajonal.

2. Administrata kontrollon të gjitha veprimtaritë e biznesit që ushtrohen në territorin e parkut, konform dispozitave ligjore dhe merr masat e nevojshme për pezullimin apo kufizimin e gjitha veprimtarive që çënojnë qëllimin dhe objektivat e menaxhimit të Parkut.

3. Administrata merr masat e nevojshme për të ndaluar ose menjanuar sa më shpejt që të jetë e mundur shfrytëzimin ose veprimtarinë në të gjithë territorin, sigurimin dhe respektimin karakteristikave ekologjike, biologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike apo pejzazhit, të cilat kanë ndikuar në dhënien e statusit të Parkut Natyror Rajonal.

4. Administrata planifikon dhe zbaton ndërhyrjet e nevojshme për parandalimin, luftimin e dëmtuesve dhe të sëmundjeve, helmeve e ndotjes të cilët shkaktojnë dëme në mjedis e që përfshihen në territorin e Parkut Natyror Rajonal dhe ndalon zbatimin e projekteve e të veprimtarive që bien ndesh me planin e menaxhimit të zonës.

5. Administratat nuk lejon kryerjen e çfarëdoq ndërtimi apo infrastrukture brenda territorit të Parkut Natyror Rajonal, pa patur lejet përkatëse dhe të pa mbështetura në studimet urbanistike, sipas dispozitave ligjore të ligjit "Për planifikimin e territorit".

Neni 17

Ndryshimet në rregullore

1. Ndryshime të mundshme në këto rregullore mund të behen në varesi të kushteve dhe rrethanave të ndryshme, me qëllimin përmirësimin e menaxhimit të parkut.
2. Ndryshimet behet dhe miratohen nga autoritetet kompetente, me propozimin e administratës së parkut, apo ndonjë autoriteti tjetër i cili paraqet argumentimet përkatëse për ndryshimet e propozuara.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit final të shpalljes së Parkut Natyror Rajonal nga Ministria e Mjedisit.

KËSHILLI I KOMUNËS LEKBIBAJ